




Ndryshon TVSH-ja për sektorin bujqësor - Braçe: Favorizohet prodhimi vendas dhe i shërben formalizimit të sektorit

Faqe 2



AmCham kërkon shtyrjen e miratimit të ligjit për përpunimin e mbetjeve nga prodhuesit

Faqe 2



Jaupllari: Farat e fidanët e certifikuar, ndryshimet ligjore garantojnë cilësi

Faqe 4



AGROBIZNESI

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit shkurt 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 503
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

BUJQËSIA DHE AGROBIZNESI KREDI ME INTERES 2% 250 MILIONË EURO KREDI TË BUTA, DENAJ: ULET NORMA E INTERESIT NË 2% PËR BIZNESET NË 5 SEKTORË KYÇË TË EKONOMISË

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar mbështet dhe është aktor aktiv i nismës së lançuar nga qeveria dhe BSH për financimin e bujqësisë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur konsultimet për programin e ri mbi financimin në bujqësi, ku përmes një instrumenti bankar me një linjë financimi prej 250 milionë euro, do të mbështeten investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME | **ALBANIA**

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Denaj pret ambasadorin italian, rritje e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë



Faqe 4

SIGURI USHQIMORE

Shitësit ambulante - Haderi - AKU dhe Policia Bashkiake sfidë disiplinimin e tyre



Faqe 4

INSTAT

Blegtoria drejt rënies, numri i gjedhëve u përgjysmua dekadën e fundit



Faqe 2

KËNDI I EKSPERTIT

Libri "Bujqësia Biologjike" me autor Prof. Ass. Dr. Enver Isufi, një material me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë

Prof. Endrit Kullaj, pedagog në Universitetin e Bujqësisë, Tiranë

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Kooperativa e ngritur në Këmishtaj nga fermerë të kthyer nga emigracioni, eksporton bimë aromatike në Europë e SHBA Fq.4
- Apel i sipërmarrjes: Mbroni midhjen në liqenin e Butrintit Fq.4
- Rehabilitohet argjinatura në Seman, Rama: 250 milionë euro garanci sovranë për ata që duan të investojnë në bujqësi Fq.6
- Eksportet e vajit të ullirit bien 97% Fq.6
- Bimësia spontane e mureve - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

TEMA TË DITËS

Balluku me agro-mekanizatorë në Fier: Mbështetje të pakursyer

Zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Infrastruktura dhe Energjisë, si dhe drejtuesit politikë e PS në qarkun e Fierit, u takua me fermerët të zonës së Topojës (Fier).

Balluku i siguroi ata për mbështetje nga ana e qeverisë për të rritur sipërfaqen e tokës së punuar dhe prodhimin.

“Bisedë konstruktive me agro-mekanizatorët mbi shqetësimet dhe problematikat e sektorit, me fokus adresimin dhe koordinimin e punës, për të lehtësuar dhe ardhur në ndihmë atyre që i janë përkushtuar tokës dhe prodhimeve. Mbështetje të pakursyer”, u shpreh ajo.

Pak ditë më parë qeveria prezantoi edhe skemën e re të

Garancisë Sovrane, një nismë që synon të lehtësojë aksesin në financa për fermerët dhe bizneset bujqësore.



Përmes një instrumenti bankar me një linjë finan-

cimi prej 250 milionë euro do të mbështeten investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, ino-

vacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural.

Blegtoria drejt rënies, numri i gjedhëve u përgjysmua dekadën e fundit

Në Shqipëri, nga viti në vit, ka më pak dhi, dele dhe lopë. Braktisja e fshatrave dhe faktorë të tjerë që lidhen me mundësitë

e mbarështimit të tyre bëjnë që numri i tyre të tkurret rreth 10%.

Të dhënat e INSTAT tregojnë se numri i të imtave për

vitin 2024 ishte 1.8 milion, ndërsa numri i gjedhëve 283 mijë. Për një dekadë, vihet re një përgjysmim i tyre, pasi në vitin 2014, në vendin tonë mbarështoheshin 2.7 milion të imta dhe 498 mijë gjedhë.

Sipas qarqeve, kryesojnë për mbarështimin e gjedhit, Fieri dhe Korça, ndërsa përqendrimi më i madh i numrit të deleve është në qarkun e Vlorës dhe Gjirokastrës me 15%. Zhvillimet e viteve të fundit kanë bërë që sektori të fillojë të ndiejë mungesën e prodhimit vendas të mishit dhe qumështit, ndërsa blegtorët ankohen edhe për politika të padrejta që u bëhen atyre me çmimet, tregun dhe mbështetjen nga qeveria



AmCham kërkon shtyrjen e miratimit të ligjit për përpunimin e mbetjeve nga prodhuesit

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) kërkoj shtyrjen e miratimit të projektligjit “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”, për të cilin kanë nisur diskutimet në komisionet parlamentare.

AmCham përcolli në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese komentet për projektligjin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesve.

AmCham thekson se ligji në gjendjen aktuale jo vetëm nuk është konsultuar me organizatat e biznesit, por shfaq disa mangësi teknike që e bëjnë atë të pazbatueshëm dhe për rrjedhojë nuk realizon qëllimin për të ndikuar në ruajtjen e ambientit.

“Dhoma kërkon shtyrjen e miratimit të këtij projektligji për të pasur mundësinë e re-



flektimit të të gjitha shqetësimeve që vijnë nga biznesi dhe që e bëjnë më efikas zbatimin e tij”, bëri të ditur AmCham.

Projektligji ka si qëllim të krijojë sistemin e përgjegjësisë së zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjener-

ojnë mbetje dhe të sigurojë që çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale, produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë për riciklimin e këtyre produkteve.

Ndryshon TVSH-ja për sektorin bujqësor - Braçe: Favorizohet prodhimi vendas dhe i shërben formalizimit të sektorit

Komisioni i Ligjeve ka miratuar ndryshimet në ligjin e TVSH-së për sektorin e bujqësisë, të propozuar nga deputeti i Partisë Socialiste Erion Braçe.

Nisma synon njehsimin e masës së TVSH-së si në shitje, ashtu edhe në blerje, teksa gjatë prezantimit në komision, Braçe tha se ky mekanizëm i ri për përllogaritjen e TVSH-së, jo vetëm favorizon prodhimin vendas, por do të ndikojë edhe në formalizimin e sektorit.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave u shprehën kundër propozimit të deputetit, pasi sipas tyre është duke u hartuar legjislacioni i ri me ndihmën e partnerëve europianë.

Në projektligjin e tij, Braçe kërkon një shtesë në nenin ku parashikohen zbritja e TVSH-së nga personat e tatueshëm, duke shtuar TVSH-në e përllogaritur mbi vlerën përfundimtare të transaksionit për blerjen e produkteve bujqësore, blegtorale (bimore e shtazore), peshkore dhe pyjore nga personi i tatueshëm tek fermerët



NDRYSHON TVSH-JA PËR SEKTORIN BUJQËSOR
BRAÇE: FAVORIZOHET PRODHIMI VENDAS DHE I SHËRBEJ FORMALIZIMIT TË SEKTORIT



NDRYSHON TVSH-JA PËR SEKTORIN BUJQËSOR
BRAÇE: FAVORIZOHET PRODHIMI VENDAS DHE I SHËRBEJ FORMALIZIMIT TË SEKTORIT

me autofaturim.

Për efekt të kësaj pike “vlera përfundimtare e transaksionit” është vlera për produktet e mësipërme në transaksionin

e blerjes së produkteve nga fermerët, dokumentuar me një faturë ligjore të dakordësuar mes paleve, ku përfshihet dhe vlera e TVSH-së.

Rindërtimi i kanalit kullues të Gjazës, mbrojtje 1500 hektarëve tokë bujqësore

Kanali kullues i Gjazës në Lushnjë i është nënshtruar riparimit në pjesën fundore të tij.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se rehabilitimi i pjesës fundore të kanalit, shmanget përmbytjet për një sipërfaqe toke prej 1500 ha.

“Ky kanal si një nyje kryesore e skemës kulluese LUK 1, siguron largimin e ujërave me rrjedhje të lirë drejt detit Adriatik, duke mbrojtur 1500 hektarë tokë bujqësore në njësitë administrative Allkaj, Shegan dhe Krutje”, informoi Denaj.

Aktualisht po rehabilitohet pjesa fundore prej 7600 metër lineare.

“Ky investim rrit sigurinë

ndaj përmbytjeve dhe garanton rritjen e rendimentit dhe cilësinë e prodhimeve”, tha Denaj.

Për përmirësimin e infrastruktura së ujitjes dhe kullimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka parashikuar një buxhet prej 2.9 miliardë lekësh për vitin 2025, që është një rritje prej 13% krahasuar me vitin e kaluar.

Ky buxhet do të përdoret

për përmirësimin e sistemeve të ujitjes dhe përfundimin e rehabilitimit të disa projekteve në rreth 16,000 hektarë tokë bujqësore.

Sipërfaqja ujtitëse e rehabilituar është dyfishuar në 10 vitet e fundit. Nga 135 mijë ha në 2015, ka arritur në rreth 265 mijë ha. Kjo sipërfaqe përbën rreth 75% të sipërfaqes potencialisht të ujtitshme për tokat bujqësore.



Fidanët e rinj, ka nisur mbjellja e qepujkave dhe disa perimeve

Me përfundimin e mbjelljes së fidanëve, ka filluar sezoni i mbjelljes së qepujkave dhe farërave të tjera bujqësore.

“Përfundoi sezoni i mbjelljes për fidanët dhe tani e ka radhën qepujka dhe më pas fillojnë perimet”, u shpreh agronomi Çelik Stanishi.

Sa i përket perimeve, për

momentin ka nisur vetëm mbjellja e spinaqit, ndërsa për të tjerat duhen edhe dy javë kohë sipas agronomit Çelik Stanishi.

“Ka filluar spinaqi dhe sallata ndërsa pjesa tjetër s’ka filluar akoma duhen dhe nja dy javë”, tha Stanishi.

Në procesin e mbjelljes,

një element kyç mbetet edhe përgatitja e tokës. Ka disa specifika që fermerët duhet të zbatojnë për të siguruar një prodhim të mbarë dhe në sasi të kënaqshme.

Në javët në vijim pritet që fermerët të mbjellin farërat e tjera që janë në periudhën e tyre optimale të mbjelljes.

FINANCIM

BUJQËSIA DHE AGROBIZNESI KREDI ME INTERES 2%

250 MILIONË EURO KREDI TË BUTA, DENAJ: ULET NORMA E INTERESIT NË 2% PËR BIZNESET NË 5 SEKTORË KYÇË TË EKONOMISË

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar mbështet dhe është aktor aktiv i nismës së lançuar nga qeveria dhe BSH për financimin e bujqësisë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur konsultimet për programin e ri mbi financimin në bujqësi, ku përmes një instrumenti bankar me një linjë financimi prej 250 milionë euro, do të mbështeten investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka nisur konsultimet për programin e ri mbi financimin në bujqësi, ku përmes një instrumenti bankar me një linjë financimi prej 250 milionë euro, do të mbështeten investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj së bashku me ministren Delina Ibrahimaj, ministre Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe me drejtoreshën e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Ardita Kuçin ishin të pranishme në konsultimet për skemën e financimit me kredi të butë dhe garancinë sovranë.

Denaj solli pamje në rrjetet sociale nga takimi i zhvilluar me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar dhe përfaqësues të bankave të nivelit të dytë.

Sipas ministres Denaj, financimi përmes Kredisë së Butë dhe Garancisë Sovrane do të ndihmojë bizneset e vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor të investojnë me kushte lehtësuese.

Ministria nënvizoi se “Kredia e Butë me një linjë financimi 250 milionë euro dhe me normë interesi 3.5%, e kombinuar me Garancinë Sovrane, e ul normën e interesit në 2% për bizneset në 5 sektorë kyç të ekonomisë”.

“I urojmë mirëseardhjen biznesit dhe përfaqësuesve të bankave që u bëtë pjesë për një diskutim, për një objektiv

ja financiare për bujqësinë dhe sektorin SME (biznese të vogla dhe të mesme) është mbështetja më e madhe që është dhënë ndonjë herë në Shqipëri në këto vite. 250 milionë euro të vendosur si një skemë financimi për kredi me interes të ulët që shkon nga 2%-3.5% është një shumë e konsiderueshme që i vihet në dispozicion biznesit të vogël dhe të mesëm për të

është në sektorin e bujqësisë”, u shpreh Denaj.

Ministria Ibrahimaj nënvizoi se sot fillohet një diskutim për produktin konkret që do të ndihmojë financimin në sektorin bujqësor.

“Garancia sovranë do t’i mundësojë bizneseve që të ketë një mbulim të madh të riskut dhe një mbulim të madh të kolateralit nga garancia dhe jo më

sovrane, elementi i ekspertizës do të ndihmohet ndjeshëm pasi jo çdo bankë mund ta ketë ekspertizën në sektorin bujqësor ndërsa AZHBR është një agjenci shtetërore e cila është e përqendruar vetëm në sektorin bujqësor”, tha Ibrahimaj.

Ardita Kuçi, drejtoreshë e AZHBR-së, theksoi se nga vitit 2013 e deri në vitin 2024 kemi rreth 1100 investime në

këtij sektori.

“Nga viti 2013 deri në vitin 2022, kemi 551 investime të cilat janë mbështetur me grant ose kredi pa interes nga buxheti i shtetit, shtuar këtyre investimeve edhe 540 kontrata të cilat janë lidhur nëpërmjet programit IPARD 2, në total themi se kemi rreth 1110 investime. Nuk flasim për skema direkte për pagesa të drejtpërdrejta ndaj fermerëve të cilat kapin një shifër shumë më të lartë, por të mendojmë se nga vitit 2013 e deri në vitin 2024 kemi rreth 1100 investime në infrastrukturë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të cilat kanë sjellë një ndryshim rrënjësor të këtij sektori, duke u fokusuar në sektorët e prodhimit, agropërpunimit, të grumbullimit, të turizmit rural dhe të natyrës dhe të akuakulturës, të cilat janë sektorë gjithashtu të përfshirë në skenën e financimit me kredinë e lehtësuar dhe garancinë sovranë”, u shpreh Kuçi.

Kuçi theksoi se “subjektet e interesuar SME të vogla dhe të mesme mund të drejtohen në bankat të nivelit të dytë për të aplikuar për kredinë e lehtësuar”.



madhor të qeverisë që lidhet me zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë shqiptare. Mbështet-

realizuar progres dhe këtu një pjesë shumë e rëndësishme e biznesit të vogël dhe të mesëm

nga vetë biznesit. Përfshirjen e AZHBR-së në shqyrtimin e aplikimeve për garancinë

infrastrukturë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të cilat kanë sjellë një ndryshim rrënjësor të

25 miliardë lekë kreditim SME-ve dhe bujqësisë, bizneset nisin aplikimet pranë bankave të nivelit të dytë

Është çelur programi i ri i financimit të SME-ve, që synon të nxisë kreditimin e bujqësisë si dhe biznesin e vogël dhe të mesëm, pa kolateral me interesa respektive 2% dhe 3,5 %

Erald Themeli, drejtor i Departamentit të Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë, tha se, “programi tashmë është bërë aktiv dhe çdo biznes i këtij sektori, mund të shkoj tek një nga bankat e nivelit të dytë për të shfaqur interes për mbështetje financiare”.

Ai vuri në dukje gjatë një interviste televizive se, programi i financuar me vlerë totale 25 miliardë lekë, nga Banka e Shqipërisë është shpërndarë tek bankat e nivelit të dytë, për mbështetjen e kreditimit të bizneseve të vogla dhe sidomos atyre bujqësore.

Sipas tij, analizat e Bankës

së Shqipërisë kanë evidentuar se megjithëse kemi një rritje relativisht të shpejtë, të qëndrueshme e solide të kredisë në përgjithësi për ekonominë shqiptare dhe për bizneset në veçanti, kreditimi i biznesit të vogël e të mesëm ecën me ritme mjaft më të ngadalta në krahasim me kreditimin e sektorit të biznesit të madh apo korporatave. Ndërkohë që pjesa e kredisë që shkon për sektorin bujqësor nuk e kalon nivelin 2% të totalit të kredisë bankare për bizneset.

Për këtë arsye, nisma e fundit e Bankës së Shqipërisë për miratimin dhe vënien në zbatim të një Programi Financimi për

biznesin mikro, të vogël dhe të mesëm, ofron një mundësi për hapjen e një kapitulli të ri në kreditimin e sektorit bujqësor.



Banka e Shqipërisë i ka bërë vazhdimisht thirrje bankave tregtare që të orientohen me prioritet drejt kreditimit të sek-

torit bujqësor që financohet 4 herë më pak se bizneset mikro, ndonëse ka potenciale mjaft të mëdha për nxitjen e rritjes ekonomike dhe zgjerimin e bazës së saj në të gjithë sektorët ekonomisë.

Themeli tha se, “fondi i vënë në dispozicion nga Banka e Shqipërisë arrin vlerën 25 miliardë lekë. Fondi lëvrohet nga bankat tregtare në formën e një kredie me një normë interesi më të favorshme se normat aktuale të tregut, me një normë tavan prej 3.5%, kundrejt interesit 5,5 % apo 6% që aplikohet aktualisht nga bankat. Ndërsa kreditimi pa kolateral

për biznesin, që do të mbulohej nga fondi i garancisë sovranë të qeverisë”.

Ai bëri të ditur se, bankat tregtare kanë aplikuar dhe e kanë marrë këtë fond nga BSH për kreditimin e biznesit dhe janë vetë bankat tregtare që bëjnë përzgjedhjen e kredimarrësve mbi bazën e aplikimeve. Kohëzgjatja e kredisë është deri në 3 vjet, ndërsa zbatimi i këtij programi mbyllet në fund të vitit 2025.

Ky program do të mbështesë investimet në serra, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural.

NFORMACIONE

Shitësit ambulantë - Haderi - AKU dhe Policia Bashkiake sfidë disiplinimin e tyre

Aksionet e vazhdueshme të policisë bashkiake në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, kanë bërë që pjesa më e madhe e shitësve ambulantë në Shkodër, të disiplinohen. Me ndërtimin e tregut të ri të Rusit, shitësit ambulantë janë sistemuar në vendet përkatëse, megjithatë sipas kreut të AKU Shkodër, vazhdon të jetë një sfidë përderisa ende trotuaret nuk janë liruar siç duhet.

“Në tregun e Rusit herë pas here ka probleme me disiplinimin e tregtarëve, jemi munduar të jemi në monitorim, ti ndërgjegjësojmë por nuk kanë munguar edhe masat ndëshkuese nga policia bashkiake”, u shpreh Ramir Haderi, Drejtor i AKU-së Shkodër.

Një plan tjetër masash, në funksion të gjurmueshmërisë dhe lëvizshmërisë së kafshëve të gjalla dhe të mishit të tyre

për konsum, AKU Shkodër bashkë me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë, janë duke

të gjalla dhe për momentin në qarkun Shkodër nuk kemi pasur asnjë problem që mund të



monitoruar tregjet e kafshëve të gjalla dhe fermat.

“Në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë po kryejmë kontrolle në ferma, në tregjet e kafshëve

na cenojnë”, u shpreh Haderi.

Ndërkohë AKU, qarku Shkodër vijon kontrollet në terren për të monitoruar marketet, restaurantet dhe stabilimentet e mishit e bulmetit.

Kooperativa e ngritur në Këmishtaj nga fermerë të kthyer nga emigracioni, eksporton bimë aromatike në Europë e SHBA

Kryeministri Edi Rama ka publikuar në rrjetet sociale rastin e Besnik Koçit nga Divjaka i cili pas disa vitesh emigrim është rikthyer në vendin e tij ku dhe ka ngritur një fermë për prodhimin e bimëve aromatike.

Besi së bashku me shumë banorë të zonës, një pjesë e të cilëve të rikthyer nga emigrimi kanë ngritur kooperativën duke rritur eksportin e bimëve aromatike në shumë vende të botës.

Rama shprehet se shqiptarët e kthyer janë sot gur i rëndë në vend të vet.


Në Këmishtaj, Njësia Administrative Gradisht Divjakë, Besi ka ngritur fermën e tij duke prodhuar me standarde dhe cilësi.

Ai rrëfen se: “Si shumë bashkëatdhetarë të mi, edhe unë në vitet ‘90 emigrova ku u mora me ndërtim që më lodhi shumë shpejt. U riktheva që të bëja atë që kisha bërë që i vogël dhe me çfarë vazhdonin prindërit e mi të kultivonin. Sapo u riktheva bashkë me bashkëfshatarët e mi krijuam kooperativën që prodhonte bimë aromatike mjekësore”.

“Kooperativa e përbërë me fermerë të zonës fillimisht na krijoi mundësinë që ne të bënim standard të produkteve të certifikuara dhe të bënim një cilësi të veçantë për eksportin të cilat kërkonin vendet e zhvilluara dhe tashmë jemi kompani lider në

Ai shprehet se Shqipëria nuk është si më parë dhe tashmë ofron mundësi si në prodhimet bujqësore dhe në sektorë të tjerë.

“Por në prodhimet bujqësore ku unë përfaqësoj ka tashmë ferma janë të orientuara mbi prodhimin e tyre të qëndrueshëm



Shqipëri duke eksportuar në Europë, SHBA, Japoni dhe në disa vende të tjera. Mes 450 kontratave që ne kemi, kemi edhe shumë fermerë të terë një pjesë e tyre të rikthyer nga emigrimi duke sjell eksperiencën dhe standardet ku ata kanë punuar më parë si në Itali, Greqi dhe vendet e tjera”, thekson Besi.

dhe të certifikuar kanë të ardhura të mjaftueshme për të vazhduar jetën në Shqipëri. U bëj thirrje gjithë bashkëatdhetarëve të mi mos të punojnë tokat e të tjerëve në vendet e huaja, por të rikthehen dhe të sigurt që të ardhurat do të jenë të mjaftueshme dhe më mirë sesa aty ku janë”, apelon sipërmarrësi nga Divjaka.

Mbrojtja biologjike, vlerë për nxitjen e eksporteve bujqësore

Xhoxhi Cauli, fermer në Karbunarë e Madhe (Fier), kultivon domate të varietetit Rozalin në 3 dynmë serra, duke zbatuar praktika moderne bujqësore.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, bëri të ditur se, ai përdor mbrojtjen biologjike për të siguruar një mbrojtje natyrale ndaj dëmtuesve, në prodhimin

bujqësor.

Sipas saj, mbrojtja e biologjike është vlerë e shtuar në rritjen e cilësisë së prodhimit dhe ndikon drejtpërdrejt në rritjen e prodhimit dhe standardeve të produkteve Made in Albania.

“Prodhimet bujqësore nga ferma e tij shkojnë për shitje në tregun vendas dhe për eksport, duke kontribuar në zhvillimin

e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe ekonomisë rurale”, u shpreh Denaj.

Përdorimi i insekteve të mira për mbrojtjen biologjike në bujqësi, po gjen përdorim nga fermerët në zona të ndryshme të vendit. Të cilët me pasion për punën në bujqësi dhe përkushtim i janë kthyer përfitimeve ekonomike për familjet e tyre.

Denaj pret ambasadorin italian, rritje e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim ambasadorin italian në vendin tonë, Marco Alberti.

Ministrja Denaj bëri të ditur se gjatë takimit u diskutua për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

“Diskutuam mbi ecurinë dhe rezultatet konkrete të projekteve të përbashkëta, që po japin një kontribut të çmuar në modernizimin e sektorit tonë”, shtoi ajo.

Denaj theksoi se po ashtu u diskutua për forma të reja bashkëpunimi, duke vënë në



fokus shkëmbimin e eksperimentave dhe inovacionit mes qendrave tona të transferimit

të teknologjisë bujqësore dhe përvojës së konsoliduar italiane.

Jaupllari: Farat e fidanët e certifikuar, ndryshimet ligjore garantojnë cilësi

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin ‘Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’ sjell përfitime të prekshme për fermerët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

bëtar, ul kostot për fermerët dhe garanton fuqinë mbirëse të materialit mbjellës shumëzues bimor në treg”.

Sipas tij, projektligji garanton sigurinë e cilësisë së farave dhe fidanëve për mbështetjen e

Ndryshimet ligjore prekin mbi 40% të përmbytjes së ligjit “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” dhe forcojnë kontrollin e cilësisë në të gjithë hallkat e zinxhirit që përfshin sektori i inputeve bujqësore.

Deputeti i opozitës Xhelal Mziu, e cilësoi pr/ligjin e paraqitur një farsë të radhës, pasi siç tha ai, “sot bujqësia shqiptare është e nënçmuar ndaj prodhimeve të importit që vijnë me kosto më të ulët për shkak të subvencionimeve të konsiderueshme që marrin fermerët në vendet e tjera”.

Ai parashtroi se ka rënie të numrit të teknikëve në sektorin e bujqësisë dhe apeloj për forcimin e kontrollit nga institucionet e linjës për inputet bujqësore.

Në përgjigje të çështjeve që parashtroi deputeti Mziu, zv.ministri Jaupllari tha se, “qeveria ka shtuar nga viti në vit fondet për subvencionimin e bujqësisë dhe adreson tetë masa mbështetëse për fermerët, ku një nga këto masa është financimi për rritjen e cilësisë dhe certifikimin e farave dhe fidanëve”.



Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arjan Jaupllari i pranishëm në Komisionin e Kuvendit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin theksoi se, “projektligji rregullon procesin e regjistrimit të farave të importit, lehtëson regjistrimin e varieteteve të reja të farave në Katalogun Kom-

prodhimit bujqësor dhe rritjen e eksporteve.

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është grupi më i rëndësishëm i inputeve bujqësore dhe me një shumëllojshmëri varietetesh, kultivarësh dhe biotipesh, me ndikim të drejtpërdrejtë në prodhimtarinë e cilësinë e prodhimit.

Apel i sipërmarrjes: Mbroni midhjen në liqenin e Butrintit

Kultivuesit e midhjes në Liqenin e Butrintit, në jug të Shqipërisë, po u kërkojnë autoriteteve të marrin masa për furnizimin me ujë të freskët të liqenit nga burimet e Bistrices.

Ruajtja e ekuilibrit mes ujit të kripur dhe ujit të ëmbël të liqenit është parametri kryesor i kultivimit të midhjes që vjen vit pas viti duke u kërcënuar nga temperaturat e larta gjatë verës.

Infrastruktura e kanaleve të furnizimit me ujë të ëmbël të liqenit të Butrintit është dëmtuar dhe prej vitesh furnizimi me ujë të freskët është gjithnjë edhe më i pakët duke sjellë

humbje të midhjes.

Kultivuesit ankohen se sektori nuk ka asnjë mbështetje dhe madje nuk po u firmosen as kontratat nga autoritetet për aktivitetin e tyre në liqen.

Sorlado Nebo, një nga pjesëtarët që protestuan me kultivuesit e midhjes para bashkisë së Sarandës, hodhi në mënyrë simbolike një kovë me guacka midhjes në sallën ku këshilltarët e bashkisë po zhvillonin një takim.

Këshilltarët e Bashkisë së Sarandës pritet ta shqyrtojnë reagimin e kultivuesve të midhjes së Butrintit, e cila është

baza kryesore e furnizimit me këtë produkt në Shqipëri.

Liqeni i Butrintit me sipërfaqe rreth 1600 hektarë numëron aktualisht rreth 80 impiante midhjes prej të cilave më pak se gjysma janë efektive. Midhja e Butrintit përdoret vetëm në tregun vendas dhe nuk arrin të depërtojë në tregun europian.

Prodhimi vjetor i midhjes së Butrintit shkon në mbi 10 mijë tonë por vetëm rreth 5mijë tonë arrijnë të nxirren nga liqeni, ndërsa pjesa tjetër mbetet në ujë për mungesë tregu.

AKTUALITET

Rama: Shtojmë parkimet nëntokësore, zgjidhim parkimin e dyfishtë në kryeqytet

Kryeministri Edi Rama nënvizoi nevojën për shtimin e parkimeve nëntokësore si dhe goditjen e parkimit të dyfishtë në kryeqytet.

Gjatë prezantimit të projektit për kthimin në zonë këmbësore të ish-Bllokut, me mbështetjen e rrjetit botëror “WALK 21”, kryeministri u ndal te adresimi i problemit të parkimit të makinave në kryeqytet.

“Me siguri ne do të duhet të mendojmë për më shumë akoma hapësira parkimi nëntokësore. Ka ende mundësi Tirana për të vazhduar në atë rrugë që është nisur me parkimet nëntokësore që ka sjellë një lehtësim të arsyeshëm por ende të mjaftueshëm për shkak se nevoja është ende e madhe”, tha Rama.

Hapi tjetër, sipas kryeministrit, do të jetë goditja e parkimit të dyfishtë që është problem kryesor.

“Kjo do të bëjë që shumëkush në distancë të arsyeshme të fillojë të mendojë se mund të lërë makinën dhe të mund të përdorë më shumë këmbët, duke ulur kështu

edhe vulnerabilitetin e rritur ndaj sëmundjeve kardiale dhe shumë pasojave të tjera. Për hir të së vërtetës, demokracia ka ardhur me shumë koles-

Brendshme dhe Policinë e Shtetit do të ndërhyhet për të frenuar në mënyrë dramatike dhe të domosdoshme parkimin e dyfishtë”.



terol në Shqipëri dhe pesha mesatare e popullatës është shumë më e rritur falë patjetër mirëqenies, por falë edhe shumë helmeve dhe shumë ushqimeve që mirë është që të evitohen”, shtoi Rama.

Kryeministri falënderoi projektuesit e këtij projektit të prezantuar sot, ndërsa shprehu bindjen se “më herët se sa vonë me Ministrinë e

“Kjo do të lehtësojë shumë procese të tjera pastaj dhe do të bëjë që edhe projekti të jetë funksional. Këto janë gjëra që mund të adresohen, rëndësi ka të ecim para me projektin dhe të zgjerojmë më shumë hapësirat ku i jepet prioritet këmbësorëve, duke ulur dhe duke zvogëluar hapësirat dhe mundësitë për ndotësit”, shtoi Rama.

Gjeçi: Mandarinat me pesticide janë groposur

Drejtorja e kabinetit të Ministres së Bujqësisë, Ermira Gjeçi bëri të ditur se 10 tonë mandarina me pesticide që ishin kthyer nga Kroacia janë groposur, nuk janë hedhur për konsum në treg.

Sipas saj, rasti është denoncuar nga vetë institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë.

Në një intervistë për mediet, Gjeçi tha se, “në datën 10 dhjetor 2024, ka qenë një sasi

sisht në media. Ka të bëjë me një shkelje procedure, pasi procedura kërkon që në momentin ngarkesa e cila është e destinuar për eksport, bllokohet, atëherë menjëherë operatori në momentin e mbërritjes, është i detyruar në bazë të legjislacionit në fuqi, të informojë institucionet përgjegjëse, që në rastin në fjalë është AKU, i cili ka procedurën e vet për asgjësimin e kësaj sasi në mënyrë që ne

ticideve dhe mos ndjekjen e procedurave ligjore”, tha ajo.

Gjeçi konfirmoi se, përfaqësues të AKU nuk kanë qenë pjesë e groposjes së mandarinave, por është gjurmuar rasti dhe është verifikuar groposja e tyre.

“Nuk ka qenë pjesë e ekipit që është marrë me groposjen dhe kjo është arsyeja pse rasti është çuar për ndjekje penale, sepse procedura e kërkon që Ministria njoftohet dhe ministria është pjesë e ekipit që bën groposjen. Por duke vajtur mbrapsht në zinxhirin e kontrollit pra në gjurmueshmërinë, kjo është gjurmueshmëria që ne themi, unë i vete mbrapsht deri në pikën parësore, deri në pikën e parë, është parë, është deklaruar nga fermeri dhe është parë vendi i groposjes. Kurse për rezultate të mëtejshme, sikurse jeni në dijeni, rasti është nën hetim, kështu që nuk mundemi të japim më shumë inflamacion derisa të përfundojë. Por është e verifikuar me protokoll vendgroposja”, tha ajo.

Ministria e Bujqësisë bëri me dije se është ngritur një taskforcë që merret me analizimin e çdo rasti pozitiv qoftë nga importi por edhe produkte vendi. Sipas këtij institucioni, bëhet fjalë vetëm për 4 ngarkesa që kanë rezultuar pozitive nga 923 në total.



mandarinash e destinuar për eksport, e cila është bllokuar nga autoritetet kroate pasi dyshohej për mbetje të dy produkteve që nuk janë në listën e aprovuar të Ministrisë së Bujqësisë”.

Ajo informoi se, historia nis me denoncimin që kanë bërë institucionet e varësisë të MBZHR.

“Nuk kemi të bëjmë me hedhjen e një produkti në treg ashtu sikurse po flitet gjerë-

Panairi i Punës në Greqi, Rama: Derë e re komunikimi me diasporën, mundësi rikthimi në Shqipëri

Më 2 mars në Athinë do të hapë dyert për shqiptarët që jetojnë në Greqi, Panairi i Punës, me moton: “Puno dhe jeto aty ku ke zemrën”.

Kryeministri Edi Rama përmes një videoje të shpërndarë sot në rrjetet sociale e konsideron këtë panair një “ftesë” në adresë të bashkatdhetarëve tanë në Greqi, për t’u njohur me perspektivën e kthimit të plotë a të pjesshëm me punë në atdhe, përmes panairit të parë të këtij lloji, i cili hap një derë të re komunikimi me diasporën për Shqipërinë 2030.

“Shqipëria hap kufijtë për kthimin e të rinjve dhe profesionistëve. Panairi i punës, “Puno dhe jeto aty ku ke zemrën” shkon në Athinë më 2 mars, duke ofruar mundësitë më të mira për punësim e rik-

thim në atdhe. Bashkohuni me ne për të bërë një hap të rëndësishëm për karrierën, familjen, të ardhmen”, thuhet në videon



e shpërndarë nga Kryeministri Rama.

Mesazhi u drejtohet të gjithë bashkatdhetarëve që jetojnë dhe punojnë në Greqi, që t’i bashkohen këtij panari për t’u njohur me punëdhënësit,

pagat, programet e aftësimi dhe sektorët pararojë.

Gjatë panairit do të organizohen takime me sipërmarrje

dhe agjenci shqiptare, panele diskutimi, networking dhe informacion nga tregu shqiptar i punës. “2 mars 2025, Technopolis Athinë, Shqipëria vendi juaj, mundësia juaj”, përfundon videoja.

Rama: 15 marrëveshje për pensionet, po negociojmë me Greqinë që është më e vështira

Kryeministri Edi Rama deklaroi qeveria nuk ka ndenjur duarkryq, por ka bërë 15 marrëveshje për pensionet me vendet ku janë shqiptarë.

kimit Evropian. Italia sa kohë u bë që është firmosur marrëveshja ka shkuar në parlament e shkon e vjen në komisionet e parlamentit. Ka kaluar në lexi-



Gjatë një komunikimi live në rrjetet sociale përmes rubrikës “Sy m’sy”, Rama “jemi duke negociuar me qeverinë greke që është edhe marrëveshja më e vështirë”.

“Dy ishin marrëveshjet më të mëdha dhe të vështira Italia që e mbyllëm. Shikoni se ankohehi me Shqipërinë që vonohen gjërat, bëhen shumë më shpejt gjërat këtu se në vendet e Bash-

min e parë dhe tani në leximin e dytë. Është një histori burokracie dhe procedurash që është historia e vendeve të zhvilluara. Kanë më shumë burokraci vendet e zhvilluara, nuk kanë më pak”, nënvizoi Rama.

Sidomos, vijoi Rama, me marrëveshjen e përbashkët me Italinë ne kemi garantuar që vitet punës të pensionistëve shqiptarë në Itali të njihen.

“Nuk mund të paguajë shtetit shqiptar ato vite pune që një shqiptar ka bërë në Itali dhe ka paguar shtetin italian atje. Por ama shtetit italian duhet t’ia paguajë se nuk e ka pasur skllav, por kontributor dhe nuk e ka pasur ilegal e ka pasur në sistem për sa kohë ai ka punuar dhe paguar sigurimet shoqërore. Këtë do bëjmë edhe me Greqinë”, theksoi Rama.

Kryeministri Rama vuri në dukje se “mirë apo keq, shumë herë mirë nga njëherë keq, kjo qeveri dhe unë në krye të saj jemi këtu për të bërë një detyrë”.

“Unë jam këtu për të bërë një detyrë, ndjehem në një mision, nuk jam këtu për të dëgjuar gjithfarëlloj llafesh dhe nuk jam këtu për të gëlltitur gjithfarëlloj poshtërsish dhe gjithfarërlloj sulmesh ndaj meje, ndaj familjes, ndaj njerëzve me të cilët unë punoj sepse kam ndonjë axhendë tjetër apo sepse nuk di të bëj punë të tjera apo sepse jam në një mision”, tha Rama.

Barazia gjinore në biznes dhe ligj, BB: Shqipëria ngjitet në vendin e 36-të

Banka Botërore vlerëson përparimin që ka bërë Shqipëria në drejtim të barazisë gjinore në ligj dhe biznes për femrat.

Gjatë 30 viteve të fundit, sipas raportit të Bankës Botërore “Gratë, Biznesi dhe Ligji”, Shqipëria është ngjitur në renditje, duke e përmirësuar rezultatin e saj nga 59,4 në 91,3 pike dhe duke u pozicionuar në vendin e 36-të nga 190 vende.

Në kuadër të Ditës

Ndërkombëtare të Gruas 2025, BB vlerësoi fuqinë dhe potencialin e grave dhe vajzave në transformimin ekonomik dhe social të shoqërisë.

Banka Botërore ka mbështetur Shqipërinë në zgjerimin e barazisë gjinore, duke krijuar vende të reja pune, duke forcuar mbrojtjen ligjore dhe duke promovuar mundësi të barabarta në arsim, si dhe fuqizimin e grave në drejtim

dhe në vendin e punës.

Këto reforma, vlerëson BB, po sjellin ndryshim të vërtetë në ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme në Shqipëri.

BB thekson se, zbatimi në vendin tonë i projektit të parë të këtij lloji, për Politikën e Zhvillimit, me fokus barazinë gjinore, ka luajtur një rol kyç në nxitjen e reformave kryesore, duke vendosur një precedent të fortë për politikën që fuqizojnë gratë.

(Vijon nga faqja 6)

Eksportet e vajit të ullirit bien 97%

Maroku apo Tunizia, prodhimi vendas humbi konkurrueshmërinë për shkak të çmimit të lartë të prodhimit.

“Vaji i ullirit është blerë prej fermerëve nga grumbulluesit shqiptarë me çmim 600 deri në 650 lekë për kg apo 600 lekë deri në 610 lekë për litër. Me këtë çmim, kemi grumbulluar sasi të konsiderueshme vaji të ullirit, por jo në nivele të larta. Ndërsa çmimi i vajit të ullirit në origjinë, pra nga fermeri në shtetet europiane, si Greqi, është 4.9 euro për litër, në Spanjë 3.5 euro për litër”.

Ai renditi një sërë arsyesh, pse prodhimi vendas nuk arrin të konkurrojë fqinjët.

Sipas tij, kostot e larta të prodhimit janë jo vetëm për shkak të pagave të larta për punonjësit, por edhe nga mekanizimi i ulët që nuk nxit rritjen e rendimentit, mungesa e subvencioneve për çdo litër vaj të prodhuar nga fermeri, si në Greqi, ku shteti subvencionon fermerin 1 euro për litër dhe nga niveli i lartë i informalitetit të shitjeve në vend.

Kostot

Kostot e larta të prodhimit janë jo vetëm për shkak të pagave të larta për punonjësit, por edhe nga mekanizimi i ulët që nuk nxit rritjen e rendimentit, mungesa e subvencioneve për çdo litër vaj të prodhuar nga fermeri, si në Greqi, ku shteti subvencionon fermerin 1 euro për litër dhe nga niveli i lartë i informalitetit të shitjeve në vend.

Çmimi

Gjatë sezonit të fundit 2024/2025, Spanja, Greqia, Turqia, Portugalia etj., kanë pasur një prodhim të mbarë, që ka sjellë edhe rënie të çmimit të vajit të ullirit që eksportohet në tregjet e mëdha ndërkombëtare. Çmimi aktual për vajin ekstra të virgjër në këto vende është rreth 4.5-5 euro për kg, ndërkohë që në Shqipëri është mbi 6 euro për litër.

Enea Janko, konsulent biznesi, tha për “Monitor” se prodhuesit shqiptarë të vajit të ullirit nuk janë konkurrues në tregjet e eksportit për shkak të kostove të larta të prodhimit që vjen nga çmimet e larta të shërbimeve të nevojshme, varësia e lartë nga puna e krahut dhe mungesa e automatizimit të proceseve të punës.

“Eksporti i vajit të ullirit, në kushtet që punohet në Shqipëri, varet tërësisht nga koniunkturat e tregut ndërkombëtar.

Në dy vitet e shkuara 2023 dhe 2024 u rrit sasia e eksportit të vajit nga Shqipëria, sepse vendet si Spanja dhe Italia, që dominojnë tregun botëror, patën një rënie të madhe të prodhimit për dy vite me radhë, për shkak të mungesës së reshjeve.

Gjatë sezonit të fundit

2024/2025, Spanja, Greqia, Turqia, Portugalia etj., kanë pasur një prodhim të mbarë, që ka sjellë edhe rënie të çmimit të vajit të ullirit që eksportohet në tregjet e mëdha ndërkombëtare.

Çmimi aktual për vajin ekstra të virgjër në këto vende është rreth 4.5-5 euro për kg, ndërkohë që në Shqipëri është mbi 6 euro për litër.

Një faktor është edhe mungesa e subvencioneve qeveritare, ndërkohë që prodhimi i vajit të ullirit në Spanjë, Itali, Greqi, Portugali, etj. financohet në një masë të konsiderueshme nga BE, por edhe nga fondet e qeverive të këtyre vendeve.

Një problem tjetër janë çmimet e larta të analizave laboratorike dhe mungesa e mbështetjes së fermerëve nga institucione të specializuara me informacionin e nevojshëm për ruajtjen e cilësisë së vajit të ullirit, sipas standardeve ndërkombëtare.

Cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri dëmtohet shumë nga përdorimi i pesticideve të ndaluara, por edhe nga mungesa e depozitave të inoksit për ruajtjen e tij, si dhe nga niveli i ulët teknologjik për mbushjen dhe paketimin e vajit në shishe qelqi apo paketime të tjera të përshtatshme.

Është skandaloze kur shikon që vaji i ullirit në Shqipëri shitet rrugëve pa asnjë lloj kushti me bidonë plastikë, por është më skandaloze kur shikon që ky lloj vaji me këto lloje paketimesh dhe jashtë çdo kontrolli të sigurisë ushqimore eksportohet në vendet e BE dhe SHBA nëpër furgonë, autobusë apo edhe nëpër kontejnerë në cilësinë e konsumit personal nga shqiptarët që jetojnë në këto vende”.

Rënia e eksporteve po nxit rritjen e stokut të vajit në shtëpitë e fermerëve

Përpunuesi, grumbulluesi dhe eksportuesi i vajit të ullirit nga Belshi, Aldo Jolla, 80% të sasisë prej 80 tonësh vaj që po e mban në depozitat e inoksit e ka nga prodhimi i ullishteve të tij. Sasia tjetër e vajit të magazinuar është në pronësi të familjarëve të tij.

Sipas z. Jolla, sasia e vajit që fermeri sjell për ta mbajtur në depozita inoksi është e ulët, e ndarë sipas aciditeteve të vajit. Shkak mbetet kostoja e magazinimit dhe ruajtjes së vajit të ullirit që është e papërballueshme prej fermerëve.

Për rrjedhojë mosgjetja e tregjeve për eksport po nxit shtimin e stokut të vajit të pashtur që mbahet në shtëpi nga fermerët. Grumbulluesit vendas pohojnë se kjo mund të sjellë dëmtimin e cilësisë.

Sasia e vajit që po bllokohet në shtëpitë e fermerëve është e

lartë. Ne kemi kapacitete për ruajtje, por kostoja është e lartë dhe nuk përballohet financiarisht nga fermerët. Vaji duhet të nëndahet sipas aciditeteve për t’u ruajtur në depozita inoksi.

Kjo garanton ruajtjen e cilësisë, në të kundërt nëse vaji mbahet në shtëpi në bidonë plastikë brenda pak muajve e humb cilësinë”, pohon Aldo Jolla, përpunues dhe eksportues në Belsh.

Edhe grumbullues të tjerë pohojnë se kanë kapacitete ruajtëse në kushte optimale për vajin e ullirit, por kjo nuk po shfrytëzohet plotësisht prej tyre për shkak të paleverdishmërisë së çmimit në eksport. Ndërsa kërkesa në tregun e brendshëm është mbingopur.

Nëse vaji nuk ruhet në depozita dhe ndahet sipas aciditeteve deri në muajt korrik-gusht rrezikon t’i përgjysmohet cilësia”, tha më herët Ylli Hajdini, nga kompanisë “S.E.D – Borsh”.

Krahasuar me prodhimin e muajve tetor-nëntor, në muajin dhjetor 2024 sipas prodhuesve, rendimenti i vajit është rritur ndjeshëm nga 11 litër që prodhohej për 1 kv ullinj, aktualisht po prodhohet 20 litra vaj për 1 kv ullinj.

Rritja e rendimentit u nxit nga reshjet e shumta, pas motit të nxehtë të muajit tetor.

Rriten ndjeshëm importet

Ndryshe nga ecuria e eksporteve të vajit të ullirit, importet për janar 2025 kanë shënuar rritje të ndjeshme. Sipas të dhënave të Doganave, në këtë periudhë sasia e importeve shënoi rritje rreth 30 herë më shumë se muaji janar 2024.

Në total, për vitin 2024 u importuan 419 mijë kg vaj ulliri, sasia më e lartë e importuar pas vitit 2020. Krahasuar me 2023, importet janë rritur 10 herë më tepër.

Nga të dhënat e Doganave rezultojnë se për 2024 ishin 52 operatorë që importuan vaj ulliri. Shumica e operatorëve importues janë rrjete supermarketeshe dhe distributorë ushqimorë.

Prodhuesit pohojnë se shtimi i importeve të vajit të ullirit prej supermarketeve është nxitur nga çmimi më i favorshëm i vajit të ullirit që ofrohet jashtë dhe nga rënia e euros.

Zgjidhjet që rekomandojnë operatorët dhe ekspertët

Për uljen e kostos së prodhimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbështet fermerët kultivues të ullinjve nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes nga buxheti i shtetit, me një paketë masash që nga dhënia e naftës pa akcizë dhe me paketën e investimeve për blerjen e traktorëve me qëllim mekanizimin e prodhimit.

Sipas të dhënave nga AZHBR, në vitin 2023 kanë përfutuar në total 53,154 fermerë nga masa mbështetëse e naftës, nga të cilat rreth 36% e tyre ishin aplikime me ullishte përfutuese (specifikisht 19,222 aplikime), me numër parcelash prej 35,808 ose 16,505 hektarë sipërfaqe me ullishte.

Nga të dhënat paraprake të vitit 2024, ka pasur rritje të fermerëve aplikues me ullishte te masa e naftës, me një numër prej 19,492 aplikimesh, me 43,870 numër parcelash dhe një sipërfaqe prej 20,208 hektarësh me ullishte.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të prodhimit në ferma, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përfshiu në paketën e masave mbështetëse për vitin 2024 edhe disa investimeve prioritare dhe me ndikim të fermerët, si: Mbështetje të investimeve për ndërtimin e serrave dhe stallave, për rrjeta antibreshër, mekanikë bujqësore dhe akuakulturë.

Mbështetja për mekanizimin në sektorin e bujqësisë është pjesë e paketës së investimeve, duke qenë domosdoshmëri për rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostove të prodhimit.

Fermerët që kultivojnë kulturën e ullirit, duke aplikuar në Skemën e Investimeve për masën mbështetëse “Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale” përfitojnë grant deri në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 lekë për subjekt.

Përfutuesve të financimit nga masat e mbështetjes së investimeve u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka.

Në aplikimet e bëra në këtë skemë grantesh që përfundoi në datën 8 nëntor 2024, rreth 75% e aplikimeve ishin për mekanikë bujqësore, përfshirë edhe ullirin.

Por për fermerët, masat e dhëna rezultojnë të pamjaftueshme me qëllim uljen e kostove prodhuese dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Ata kërkojnë dhënie të subvencioneve direkte për sasinë e prodhuar, të njëjtat masa që aplikohen edhe nga vendet fqinje.

“Fermerët nuk mund ta përballojnë të vetëm koston e prodhimit për të konkurruar në tregjet e huaja. Me çmimin e kërkuar prej 350 lekësh për litër të vajit të ullirit, fermeri nuk arrin dot të përballojë as kostot e përdorura për pesticiditet.

Është e domosdoshme që kultivuesit e ullirit të ndihmohen me subvencione direkte për sasinë e vajit të prodhuar siç ndodh në vendet e tjera.

Vetëm dhënia e naftës falas nuk e ndihmon kultivuesin e ullirit të konkurrojë në tregjet e huaja”, pohon eksportuesi i vajit të ullirit, Aldo Jolla.

Enea Janko, konsulent biznesi, tha se mundësitë për rritjen e qëndrueshme të eksportit të vajit të ullirit nga Shqipëria ekzistojnë, sidomos në SHBA që është tregu më i madh në botë për eksportet e vajit të ullirit dhe ku jetojnë mbi 100 mijë familje shqiptare, por nga Ministria e Bujqësisë po punohet shumë pak për rritjen e zinxhirit të vlerës.

“Fatmirësisht në SHBA, bashkatdhetarët tanë kanë në pronësi dhe menaxhojmë me mijëra restorante, kompani importi dhe distribucioni të ushqimeve, si dhe markete të njohura, por interesimi nga MBZHR ka qenë shumë i vogël për t’i kontaktuar dhe për të krijuar bashkëpunime me interes për rritjen e eksporteve të produkteve shqiptare.

Ndërkohë që nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por edhe nga vetë prodhuesit, po punohet shumë pak për krijimin, zhvillimin dhe fuqizimin e markave shqiptare të vajit të ullirit, si dhe për njohjen e tregjeve, ku vaji shqiptar paraqet avantazhe konkurruese dhe për promovimin konkret të këtyre produkteve”, veçon ai.

Çfarë masash po merr Ministria e Bujqësisë?

Për zgjidhjen e problematikës së përsëritur të prodhimit të vajit të ullirit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pohon se aktualisht është në fazën e vlerësimit të projektit që synon krijimin e konsorciumit të prodhuesve të vajit të ullirit, nëpërmjet formimit të cluster-ave (grupimeve) në rajonin e Beratit.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, projekti, me vlerë investimi rreth 900,000 USD, synon të bashkojë 50 fermerë dhe prodhues nga Qarku i Beratit, ku përveç orientimit që do t’u jepet fermerëve për përmirësim të teknikave të kultivimit dhe vjeljes, do të ngrihet stabiliteti për ruajtjen e vajit në tanke inoksi.

“Ky konsorcium do të shërbejë si një strukturë bashkëpunimi ndërmjet fermerëve, prodhuesve dhe ekspertëve të fushës, me qëllim forcimin e zinxhirit të vlerës së vajit të ullirit (ullirit të tavolinës dhe vajit të ullirit) nga kultivimi deri te tregtimi i tij në tregjet ndërkombëtare.

Ky projekt është konceptuar për të zgjidhur sfidat kryesore që përballen prodhuesit shqiptarë të vajit të ullirit, siç janë cilësia e produktit, kapacitetet e kufizuara të ruajtjes dhe ambalazhimit, si dhe mungesa e një identiteti të fortë tregtar që mund të përfaqësojë me dinjitet Shqipërinë në tregun europian.

Synimi është që konsorciumi të bashkojë rreth 50 fermerë

dhe prodhues të vajit të ullirit nga rajoni i Beratit, duke krijuar një rrjet të qëndrueshëm prodhimi dhe përpunimi, ku praktikant më të mira agronomike dhe teknologjike do të jenë në qendër të vëmendjes.

Nëpërmjet trajnimeve të specializuara dhe asistencës teknike, do të përmirësohen metodat e kultivimit, përpunimit pas vjeljes dhe ruajtjes së vajit me teknologji moderne, duke siguruar një produkt me cilësi të lartë që përmbush standardet e Bashkimit European.

Një komponent thelbësor i projektit është ndërtimi i një qendre shumëfunksionale në një nga bashkitë e Qarkut të Beratit, e cila do të shërbejë si një stabiliment për ruajtjen e vajit të ullirit në tanke inoksi, duke garantuar ruajtjen e cilësisë dhe karakteristikave organoleptike të produktit.

Kjo qendër do të jetë e pajisur me linja të specializuara për ambalazhimin dhe paketimin e vajit të ullirit, duke e bërë atë të gatshëm për tregjet më të kërkuara ndërkombëtare.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm është brandimi dhe certifikimi i vajit të ullirit me tregues gjeografikë të mbrojtur (IG), duke theksuar origjinën dhe cilësitë unike të vajit të Beratit”.

Ky projekt, me vlerë investimi rreth 900,000 USD, është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj sfidave që paraqet tregu global i vajit të ullirit, sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili është ndikuar ndjeshëm nga faktorë si ndryshimet klimatike dhe rënia e prodhimit në vendet tradicionale si Spanja dhe Italia.


“Ndërkohë që prodhimi global është në rënie, për shkak të sfidave të tilla, si thatësira dhe dëmtuesit e kulturave të ullirit, Shqipëria ka një mundësi të artë për të rritur praninë e saj në tregjet ndërkombëtare, duke ofruar një produkt cilësor dhe të certifikuar që plotëson kërkesat e konsumatorëve më të sofistikuar.

Në këtë kuadër, rajoni i Beratit, me traditën e tij të gjatë në kultivimin e varieteteve autoktone si ‘Ulliri Kokërrmadh i Beratit’, përfaqëson një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e një identiteti të fortë rajonal.

Konsorciumi do të mbështesë jo vetëm përmirësimin e praktikave prodhuese, por edhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e certifikimit të cilësisë dhe përdorimit të treguesve gjeografikë, duke ndihmuar kështu në pozicionimin e vajit të ullirit shqiptar si një produkt premium në tregun e Bashkimit European dhe më gjerë”, theksohet nga Ministria e Bujqësisë.

Projekti i mbështetur nga Banka Botërore pritet zbatohet edhe në qarqe të tjera të vendit.

“Monitor”



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



KËNDI I EKSPERTIT

Libri “Bujqësia Biologjike” me autor Prof. Ass. Dr. Enver Isufi, një material me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë

Prof. Endrit Kullaj, pedagog në Universitetin e Bujqësisë, Tiranë

(Fjala e mbajtur me rastin e përurimit të këtij libri në Akademinë e Shkencave)



Të nderuar akademikë, pedagogë, kolegë dhe miq të bujqësisë biologjike,

Në lëmin e gjerë të tematikave që trajtohen në këtë sallë të nderuar të Akademisë së Shkencave, sot kemi kënaqësinë të prezantojmë librin “Bujqësia Biologjike”, me autor Profesor Ass. Dr. Enver Isufi, një referencë me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë. E prezantojmë sot, në një kohë kur bujqësia biologjike ose organike është një alternativë e testuar ndaj prodhimit konvencional i cili, veç dëmeve mjedisore, shkakton kaq shumë pasiguri ushqimore. I takonte Prof. Enverit ta shkruante i pari një libër të plotë mbi bujqësinë biologjike, sepse është figura më e shquar shqiptare në këtë fushë, me një kontribut të jashtëzakonshëm në promovimin dhe zhvillimin e saj. Pothuajse 30 vjet më parë ai i printe lëvizjes për bujqësi biologjike në Shqipëri. Prof. Enver Isufi ka botuar 12 libra profesionalë dhe qindra artikuj këshillues e dhjetra artikuj shkencor në sferën e mbrojtjes së bimëve dhe bujqësisë biologjike, duke përfshirë edhe librin që prezantojmë sot. Ai është gjithashtu drejtues i Institutit të Bujqësisë Biologjike, ku ka udhëhequr projekte të shumta kërkimore dhe ka ofruar këshilla praktike për fermerët dhe specialistët. Përveç veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore, Prof. Enver Isufi ka qenë aktiv në promovimin e politikave dhe praktikave të qëndrueshme në bujqësi, duke theksuar rëndësinë e ndryshimit të psikologjisë së fermerëve drejt metodave biologjike dhe miqësore me mjedisin. Është pikërisht kjo e fundit ajo që do të doja të nënvizoja.

Personalisht e kam ndjekur bujqësinë organike si hulumtues në drejtim të kontrollit biologjik dhe politikave mbështetëse, si inspektor për certifikimin organik, si konsulent e madje edhe si biznes. Për fat të keq, në shumë raste, shumë fermerë apo tregtarë i janë qasur organikes/biologjikes, nga pozita pragmatiste – pra, kur ka subvencione ose treg “bëj” prodhim organik; kur 2 nuk ka, kthehem në prodhim konvencional. Roli i Prof. Enverit me trajnimet dhe këshillimet e tij ka arritur zhvendosjen nga këto pozita pragmatiste në të qenit fermer organik me bindje, me parime. Këtë ai e ka bërë më mirë se kushdo nga ne, jo vetëm sepse zotëron njohuri të thelluara që i japin zgjidhje problemeve, por sepse është vetë si njeri një personalitet BIO.

Dëshiroj të pohoj me bindje të plotë se ky botim përfaqëson një kontribut të vyer në edukimin dhe formimin e specialistëve të rinj në fushën e bujqësisë biologjike në Shqipëri.

Pjesa e parë e librit “Bujqësia Biologjike” paraqet një panoramë historike dhe konceptuale të bujqësisë si themel i mirëqenies dhe zhvillimit shoqëror, duke analizuar evoluimin e praktikave bujqësore nga epokat paraqytetëruese deri te bujqësia moderne. Autori trajton rëndësinë e qëndrueshmërisë si një domosdoshmëri për zhvillimin afatgjatë, duke theksuar avantazhet e bujqësisë biologjike në raport me metodat tradicionale dhe intensive. Në këtë pjesë nënvizohet roli i bujqësisë biologjike në pakësimin e përdorimit të plehrave dhe kimikateve, uljen e kostove, përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe mbrojtjen e biodiversitetit, duke kontribuar njëkohësisht në ruajtjen e higjienës së mjedisit dhe reduktimin e ndotjes. Përmes këtij kapitulli, libri bën të qartë lidhjen e pandashme mes bujqësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve njerëzore.

Pjesa e dytë e librit fokusohet në zhvillimin dhe zbatimin praktik të bujqësisë biologjike, duke paraqitur një analizë të thelluar mbi përvojat ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe praktikën më të mira të zbatuara në Shqipëri. Autori analizon sukseset dhe sfidat e bujqësisë biologjike gjatë një shekulli, duke shpjeguar standardet ndërkombëtare dhe strategjitë e fundit për përhapjen e këtij sistemi të qëndrueshëm. Kjo pjesë ofron të dhëna konkrete mbi zhvillimin e bujqësisë biologjike në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit, duke ilustruar ndikimin ekonomik dhe social të kësaj praktike. Me një fokus të veçantë te zbatimi lokal, kjo pjesë përshkruan zgjedhjen e farërave dhe fidaneve cilësore, ngritjen e fermave biologjike dhe harmonizimin e praktikave tradicionale me standardet bashkëkohore, duke ofruar një udhëzues praktik për lexuesit që synojnë të adoptojnë këtë qasje inovative.

Pjesa e tretë e librit është një shtyllë e rëndësishme që trajton ushqimin e bimëve dhe përkujdesjen ndaj tokës bujqësore në kuadrin e bujqësisë biologjike, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së pjellorisë dhe cilësisë së tokës për zhvillimin e qëndrueshëm të bimëve. Autori analizon faktorët që ndikojnë në shëndetin e tokës dhe ndan qartë dallimet mes bujqësisë biologjike dhe asaj konvencionale, duke nxjerrë në

pah qëndrueshmërinë dhe përfitimet afatgjata të metodave biologjike. Në këtë pjesë prezantohen teknikat për përgatitjen dhe përdorimin e plehut organik, prodhimin e kompostit dhe praktikën për kullimin dhe përmirësimin e tokave, gjithmonë duke ruajtur ekulibrin ekologjik. Pjesa ofron një udhëzues të detajuar dhe praktik për fermerët dhe specialistët, duke treguar sesi bujqësia biologjike ruan jo vetëm cilësinë e tokës, por edhe burimet natyrore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Pjesa e katërt e librit paraqet një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse mbi mbrojtjen e bimëve në bujqësinë biologjike, duke u fokusuar te teknikat dhe qasjet shkencore që sigurojnë shëndetin e bimëve dhe ruajtjen e ekosistemeve. Autori ndërthur shkencën dhe praktikën për të ndihmuar specialistët dhe fermerët të menaxhojnë sfidat e mbrojtjes së bimëve, duke shmangur përdorimin e pesticideve sintetike. Kjo pjesë thekson ndërveprimet ekologjike midis gjallesave dhe faktorëve mjedisorë, trajton ciklet jetësore të dëmtuesve kryesorë dhe analizon sëmundjet kërpuçdhore, bakteriale dhe virusale, duke ofruar zgjidhje praktike për trajtimin e tyre. Përmes qarkullimit bujqësor, përdorimit të farërave cilësore dhe monitorimit të vazhdueshëm, autori propozon metoda që forcojnë mbrojtjen e qëndrueshme. Roli i insekteve polenizues dhe biodiversitetit është veçanërisht i theksuar, duke nënvizuar rëndësinë e një qasjeje harmonike dhe ekologjike për menaxhimin e sfidave bujqësore.

Pjesa e pestë e librit është një nga më të pasurat dhe praktikat, duke trajtuar mbrojtjen biologjike të bimëve në kultura të ndryshme si perimet, pemtaria, vreshtaria dhe ullishtaria, përmes metodave të avancuara që garantojnë qëndrueshmërinë ekologjike. Autori prezanton zgjidhje specifike për sfidat kryesore, përfshirë përdorimin e teknikave moderne si feromonet dhe programet kompjuterike për menaxhimin e dëmtuesve, si dhe trajtime biologjike për sëmundjet të rëndësishme si vrugu i hardhisë dhe sëmundjet e mollëve. Në këtë pjesë përfshihen gjithashtu udhëzime për kufijtë ekonomikë të dëmit dhe rëndësinë e profesionalizmit në mbrojtjen biologjike, duke nxitur aplikimin e metodave miqësore me mjedisin dhe të

Libri “Bujqësia Biologjike” me autor Prof. Ass. Dr. Enver Isufi, një material me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë

(Vijon nga faqja 10)

qëndrueshme. Kjo pjesë i shton një vlerë të veçantë librit, duke ndërthurur teori dhe praktikë për të ndihmuar fermerët dhe specialistët të zgjidhin sfidat praktike në bujqësi.

Pjesa e gjashtë përqendrohet te prodhimi biologjik në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë blegtorinë, pularinë, bletarinë, bimët mjekësore. Kjo pjesë shërben si një udhërrëfyes për zbatimin praktik të parimeve të bujqësisë biologjike në fusha të ndryshme. Duke u fokusuar në sektorë të ndryshëm, autori na tregon diversitetin dhe aplikueshmërinë e parimeve biologjike në fusha të shumta, duke përfshirë edhe nevojën për promovim dhe zhvillim të tregut për produkte të tilla.

Pjesa e shtatë e librit paraqet një vlerësim të thellë mbi rëndësinë strategjike të marketingut dhe certifikimit në bujqësinë biologjike, duke theksuar lidhjen jetike midis prodhimit dhe tregtimit si bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori. Përmes një analize gjithëpërfshirëse, autori trajton strategjitë për rritjen

e tregut të produkteve biologjike shqiptare dhe rolin e certifikimit për të garantuar cilësinë dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare. Përdorimi i logove kombëtare dhe ndërkombëtare, si logoja e BE-së dhe përputhja me rregulloret ligjore përshkruhen si mjete të domosdoshme për të rritur besueshmërinë e konsumatorëve dhe për të përhapur produktet biologjike në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, theksohet rëndësia e krijimit të një tregu të qëndrueshëm dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi përfitimet unike të këtyre produkteve.

Libri është ilustruar me skema origjinale dhe të kup-tueshme, fotografi të plot sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija, tabela dhe grafikë nga studime dhe vlerësime të vetë autorit në fermat biologjike të vendit tonë, duke ia rritur kështu vlerat didaktike.

Libri “Bujqësia Biologjike” shërben si një udhëzues i plotë për praktikuesit dhe studentët e bujqësisë, duke ofruar njohuri të thelluara mbi metodat dhe praktikat e

bujqësisë biologjike. Ai mund të përdoret nga nxënësit dhe studentët që ndjekin programet e studimit në bujqësi në arsimin e mesëm dhe të lartë në Shqipëri, Kosovë dhe troje të tjera shqiptare. Ky libër do të jetë ndihmesë e rëndësishme për të gjithë ata specialistë dhe profesionistë të bujqësisë të angazhuar në këshillimin bujqësor publik dhe privat që përdorin literaturë shkencore dhe teknike. Unë besoj që kjo vepër, i përgjigjet synimeve të autorit duke plotësuar kërkesat e shumë pedagogëve dhe mësuesve, kërkesve dhe profesionistëve të sektorit.

Në përfundim, dëshirojmë të theksojmë se libri “Bujqësia Biologjike” i Profesor Enver Isufit është një burim i çmuar për të gjithë ata që synojnë të thellojnë njohuritë e tyre në këtë fushë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme dhe të shëndetshme në Shqipëri. I urojmë autorit suksese të mëtejshme dhe lexuesve një përvojë të frytshme në studimin e këtij materiali të rëndësishëm.

Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë në Tiranë, Sulejman Kullolli, tha se, “23 mijë pula të ngordhura janë konstatuar në kompaninë “Rea’s”, nga gripi i shpendëve, nga 69 mijë që ka në total kjo firmë, në njësinë administrative Rrashbull, Bashkia Durrës”.

Ndërkohë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural pritet të përcaktojë vendin për asgjësimin e shpendëve të ngordhur.

Në një intervistë për mediet, Kullolli bëri të ditur se, “asnjë produkt nuk ka dalë në treg nga ferma prej 3 marsit, ndërsa do të vendoset të mërkurën pasdite për mënyrën si do të bëhet

Gripi i shpendëve, Kullolli: 23 mijë pula të ngordhura, rasti i izoluar në një kompani



asgjësimi i shpendëve të ngordhura: groposje, incen-

derimi ose dërgimi në kompani që merren me përpunimin e



shpendëve të ngordhur”. Nga hetimet e deritanishme

rezulton se kemi të bëjmë me një rast të izoluar vetëm në

subjektin “Rea’s”. “Deri tani nuk kemi dyshime për ferma të tjera të prekura me gripin e shpendëve”, informoi Kullolli.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve po vazhdon hetimin epidemiologjik në lidhje me rastin e gripit të shpendëve.

Gjithashtu, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve lidhur me situatën njoftojnë se është në fuqi urdhri për rritjen e masave të biosigurisë.

Ndërsa Autoriteti Kombëtar i Ushqimit po monitoron tregjet nëse ka produkt nga kjo kompani.

Kina zgjeron programin e subvencioneve për zëvendësimin e makinerive të vjetra bujqësore

Kina do të zgjerojë fushën e subvencioneve për zëvendësimin e makinerive të vjetra bujqësore dhe do të rrisë nivelet e subvencioneve gjatë këtij viti, njoftoi të martën Ministria e Bujqësisë dhe Çështjeve Rurale, citon “Xinhua”.

Nëntë llojeve ekzistuese të makinerive bujqësore do t'u bashkohen gjashtë kategori të reja në programin e subvencionimit, përkatësisht, makinat për mbjelljen e fidanëve të orizit, terminallet e monitorimit të tokës bujqësore, dronët për mbrojtjen e bimëve, makinat e tharjes së drithit dhe mullinjtë e miellit, thuhet në një deklaratë të ministrit.

Kina do të vazhdojë të rrisë standardet e subvencionimit për disa makineri bujqësore këtë vit. Për shembull, subvencioni maksimal për zëvendësimin e një grumbulluesi pambuku

do të rritet nga 60.000 juanë (rreth 8365 dollarë amerikanë)

dorin në mënyrë efektive obligacionet speciale të thesarit



Foto nga VCG

në 80.000 juanë për njësi, sipas deklaratës së lëshuar së bashku nga ministria dhe tre autoritetet të tjera të qeverisë qendrore.

Deklarata thekson gjithashtu se provincat duhet të për-

të alokuara për të mbështetur heqjen dhe përditësimin e makinerive bujqësore dhe të jenë vigjilente ndaj aktiviteteve mashtruese në lidhje me pretendimet për subvencione.

Meksika ndalon zyrtarisht mbjelljen e misrit të modifikuar gjenetikisht

Dhoma e ulët e Kongresit Meksikan ka miratuar një reformë kushtetuese që ndalon mbjelljen e misrit të modifikuar gjenetikisht (GM). Reforma u miratua me 409 vota pro dhe 69 kundër, me misrin indigjen të caktuar si një “element i identitetit kombëtar”, ndërsa misri i modifikuar gjenetikisht u ndalua zyrtarisht të mbillet në Meksikë, raportoi Reuters.

Reforma tani shkon në Senat për miratim përfundimtar.

Nisma e Presidentes meksikane Claudia Sheinbaum erdhi pasi një panel mosmarrëveshje tregtare vendosi në dhjetor se Meksika po shkelte Marrëveshjen Shtetet e Bashkuara-Meksikë-Kanada (USMCA) duke vendosur kufizime për misrin e modifikuar gjenetikisht, i cili kryesisht importohet nga Shtetet e Bashkuara.

Si rezultat, Meksika hoqi kufizimet në importin e misrit GM për konsum njerëzor, ush-

qim për kafshët dhe përdorime industriale.

Meksika ka ndaluar tashmë

GM me vlerë rreth pesë miliardë dollarë nga SHBA, kryesisht për ushqim për kafshët.



mbjelljen komerciale të varieteteve të misrit GM, duke pretenduar se ato mund të kontaminojnë varietetet autoktone. Megjithatë, Sheinbaum premtoi të ndalonte zyrtarisht mbjelljen e misrit të modifikuar përmes Kushtetutës.

Meksika blen çdo vit misër

Grupi Këshillimor i Tregjeve Bujqësore tha se vendimi i qeverisë për të ashpërsuar qëndrimin e saj kundër misrit GM krijon “pasiguri” në marrëdhëniet me SHBA-në, e cila është burimi kryesor i importeve të misrit të verdhë për ushqimin e kafshëve.

ANALIZË EKONOMIE

Kina në vitin 2025: një plan për sigurinë ushqimore, inovacionin dhe prosperitetin

Në një botë që përballlet me ndryshime të mëdha, pasiguri dhe pabarazi ekonomike, Kina ka shpallur "Dokumentin Qendror Nr. 1" për vitin 2025 - një



"Serrat inteligjente" në një park industrial të teknologjisë bujqësore në qytetin Jinhua, Provinca Zhejiang e Kinës lindore, 3 qershor 2024./Foto nga VCG

plan politik gjithëpërfshirës që skicon një rrugë të guximshme drejt modernizimit bujqësor. Ky dokument, i cili është deklarata e parë politike që lëshohet nga autoritetet qendrore të Kinës çdo vit, është më shumë se një plan i thjeshtë, është një deklaratë qëllimesh dhe prioritetesh. Ai sinjalizon përkushtimin e Kinës për të transformuar zonat rurale në motorë të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë, duke siguruar që askush të mos lihet pas në marshimin drejt modernizimit. Në thelbin e tij, dokumenti është një thirrje për veprim: për të thelluar reformat rurale, për të shfrytëzuar inovacionin teknologjik dhe për të mbrojtur sigurinë ushqimore të kombit. Por, përtej gjuhës politike, qëndron një histori shprese, dhe ambicie, një histori që rezonon jo vetëm në shumë se 500 milionë banorët ruralë të Kinës, por edhe me komunitetin global që kërkon zgjidhje për disa nga sfidat më të mëdha të kohës sonë.

Përprjekjet për përmirësimin e zonave rurale të Kinës gjatë dekadës së fundit kanë hedhur një bazë të fortë për arritjen e rigjallërimit gjithëpërfshirës rural, duke u përafruar me qëllimet e kombit për modernizimin dhe prosperitetin e përbashkët. Qeveria Kineze ka bërë hapa të rëndësishëm në zhvillimin rural, të nxitur nga një sërë politikash dhe iniciativash që synojnë reduktimin e varfërisë, modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e cilësisë së jetës në zonat rurale. Angazhimi i qeverisë për rigjallërimin rural ka qenë një gur themeli i strategjisë së saj më të gjerë të zhvillimit, duke reflektuar rëndësinë e adresimit të pabarazive urbano-rurale dhe sigurimin e rritjes së qëndrueshme.

"Dokumentin Qendror Nr. 1" dhe përparësitë e vendit

Duke riafirmuar përkushtimin e vendit ndaj përmirësimit të jetesës në zonat rurale si një element madhor i modernizimit kinez, dhe duke pasur parasysh pasiguritë globale dhe sfidat e

brendshme, dokumenti paraqet një plan të shënjestruar për të rritur prodhimin bujqësor, për të përmirësuar industrinë rurale dhe për të përmirësuar jetesën e fermerëve.

Zonat rurale të Kinës janë shtylla kurrizore e ekonomisë, kulturës dhe traditës së saj. Ato janë shtëpi për qindra miliona fermerë që ushqejnë kombin. "Dokumentin Qendror Nr. 1" kërkon të ndërtojë një urë mbi hendekun që ekziston midis zonave urbane dhe rurale, duke avancuar rigjallërimin rural, një vizion që shkon përtej rritjes ekonomike për të përfshirë transformimin social, kulturor dhe mjedisor. Dokumenti vendos qëllime të qarta: deri në vitin 2027, duhet të arrihet progres i dukshëm në modernizimin rural, dhe deri në vitin 2035, duhet të arrihet progres vendimtar në zhvillimin gjithëpërfshirës të zonave rurale. Kjo do të arrihet jo vetëm nga ndërtimi i rrugëve dhe shkollave, spitaleve, etj., por nga krijimi i komuniteteve të gjallëruara dhe të qëndrueshme ku fermerët mund të kenë prosperitet, të rinjtë të ndërtojnë të ardhme të mirë dhe inovacioni të lulëzojë.

Në zemër të dokumentit qëndron një mesazh i fortë: siguria ushqimore është siguri kombëtare. Dokumenti vendos sigurinë ushqimore dhe furnizimin e qëndrueshëm të produkteve bujqësore në krye të rendit të ditës. Arritjet e Kinës në këtë fushë janë tashmë të jashtëzakonshme. Në vitin 2024, vendi arriti një moment historik, duke prodhuar mbi 700 milion tonë drithë—një dëshmi e punës së palodhur dhe aftësive të bujqve kinezë. Por, sfidat po rriten. Fatkeqësitë natyrore, zvogëlimi i tokave të punueshme dhe kërkesa në rritje për produkte ushqimore me cilësi të lartë po dëmtojnë sektorin bujqësor.

Për t'i adresuar këto sfida, dokumenti skicon një strategji me shumë dimensione, si p. sh., zgjerimi i tokave bujqësore me standarde të larta. Deri në fund të vitit 2024, Kina kishte ndërtuar rreth 66.7 milionë hektarë tokash bujqësore me standarde

të larta, të pajisura me rrjetet e avancuara të ujitjes dhe të dizajnuara për t'i rezistuar thatësirave dhe përmbytjeve. Dhe me shumë rëndësi është fakti se Kina po shfrytëzon inovacionin për të minimizuar humbjet dhe për të maksimizuar vlerën bujqësore.



Dronët në një fermë në Fshatin Sihong County, të qytetit Suqian, të Provincës Jiangsu e Kinës Lindore, 16 Mars 2024./VCG

Inovacioni: motori i ri i rritjes rurale

Nëse siguria ushqimore është themeli i rigjallërimit rural, inovacioni është motori i saj. "Dokumentin Qendror Nr. 1" prezanton një koncept revolucionar: "forcat prodhuese të cilësisë së re" në bujqësi. Ky term, që përfshin teknologji si seleksionin biologjik, dronet, inteligjencën artificiale dhe sistemet digjitale, përfaqëson një ndryshim paradigme në mënyrën se si Kina i qaset bujqësisë. Analistët sugjerojnë se kjo nuk është vetëm për përmirësimin e teknikave bujqësore, por edhe për transformimin e industrive rurale përmes digjitalizimit dhe zinxhirëve modernë të furnizimit.

Henan Yimin Holding Co., një prodhues i specave në provincën Henan, duke përdorur teknologjitë 5G dhe IoT për të monitoruar kushtet e tokës në kohë reale, kompania ka reduktuar përdorimin e ujit me 50%, përdorimin e plehrave, me 30% dhe kostot e punës me 70%. Kjo nuk është thjesht një histori e efikasiteti, është një histori e fuqizimit dhe tregon se si teknologjia mund të transformojë jetët, duke i kthyer fermerët tradicionalë në sipërmarrës të përgatitur teknologjikisht.

Dokumentin thekson gjithashtu rëndësinë e rigjallërimit të industrisë së farës, të cilën e përshkruan si "çipin" e bujqësisë. Progresi i Kinës në këtë fushë është jashtëzakonisht revolucionar. Gjatë 40 viteve të fundit, rendimenti mesatar i grurit është dyfishuar, falë avancimeve në teknologjinë e seleksionimit. Sot, kërkuesit po zhvillojnë varietete të specializuara për të përmbushur nevojat e popullatave të ndryshme, nga gruri me fibra të larta, deri te niseshtja me indeks të ulët glikemik për

diabetikët. Këto inovacione nuk janë thjesht për të rritur rendimentin; ato janë krijuar dhe përdorur për një sistem ushqimor më gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Këto politika dhe programe të aplikuara, janë krijuar për të siguruar që çdo qytetar kinez, pavarësisht

kontrollin e zhvillimit të tyre.

Mbi të gjitha, do të jepet më shumë ndihmë për ata që kanë nevojë më shumë duke forcuar mbështetjen për popullsinë rurale me të ardhura të ulëta, duke rritur ndihmën sociale si një rrjet sigurie dhe duke theksuar stimulimin e forcës së brendshme lëvizëse brenda këtij grupi të popullsisë.

Për rajonet rurale ende të pazhvilluara siç duhet, shteti do të zbatojë mbështetjen e politikave të synuara - me fokus kryesor në nxitjen e rigjallërimit dhe zhvillimit të tyre. Ndihma e diferencuar do të ofrohet nëpërmjet mekanizmave të tillë si bashkëpunimi midis rajoneve lindore dhe perëndimore dhe asistencë e synuar, duke u mundësuar këtyre rajoneve që gradualisht të arrijnë në procesin e modernizimit.

Përprjekje dhe direktiva politike të qarta

Më 18 dhjetor të vitit të kaluar, Presidenti kinez Xi Jinping bëri thirrje për përsheptimin e reformave të thelluara rurale dhe arritjen e përparimeve të qëndrueshme në bujqësi. Xi vuri në dukje se qeverisja kineze, në të gjitha nivelet duhet t'i japin përparësi zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale. Ai kërkoj përsheptimin e modernizimit bujqësor dhe rural, konsolidimin e bazave bujqësore të vendit dhe rritjen e prosperitetit në këto zona dhe për fermerët, për të përparuar me vendosmëri drejt objektivit të ndërtimit të një fuqie të fortë bujqësore.

Këto udhëzime të Xi u transmetuan dhe u diskutuan



Degët e domates në një park demonstrimi të shkencës dhe teknologjisë bujqësore në qytetin Xinzhuang, në provincën Jiangsu të Kinës lindore, 25 shkurt 2025./VCG

"Dokumentin Qendror Nr. 1" i Kinës është më shumë se një plan politik vendor; është një mesazh që tregon se zhvillimi rural është i arritshëm nëse ka vullnet. Duke investuar në bujqësi, duke fuqizuar fermerët dhe duke shfrytëzuar inovacionin, Kina po siguron të ardhmen e saj dhe po kontribuon në sigurinë ushqimore globale. Ai thërret për përsosjen e politikave të tokës rurale, zgjerimin e urbanizimit dhe fuqizimin e fermerëve lokalë për të marrë

në një konferencë të posaçme. Me pak fjalë, fokusi i niveleve më të larta të politikëbërjes së Kinës, ka qenë dhe është zhvillimi i qëndrueshëm rural. Vetë Presidenti Xi Jinping ndër vite ka treguar sa e rëndësishme është kjo për kombin. Të gjitha këto deklaratat janë bërë në kontekste kyçe për politikën dhe strategjinë e zhvillimit rural të Kinës, shpesh në konferenca të nivelit të lartë dhe forume qendrore të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik. Si

për shembull:

"Pa një bujqësi moderne, nuk mund të ketë një Kinë moderne." Thënë në vitin 2013, gjatë Konferencës Qendrore të Punëve Rurale.

"Zhvillimi rural nuk është vetëm për përmirësimin e infrastrukturës dhe të ekonomisë rurale, por gjithashtu për ngritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e mirëqenies së njerëzve që jetojnë në këto zona." Shprehur në vitin 2015, në Forumin e Zhvillimit Rural në Pekin.

"Zhvillimi i zonave rurale duhet të ndjekë një qasje të gjithanshme për t'i bërë fshatrat më të pasura, më të bukura dhe më të zhvilluara." Thënë në vitin 2017, Kongresi i 19-të i PKK-së.

"Rigjallërimi rural është një strategji kyçe për të arritur një shoqëri të moderuar në mënyrë të gjithanshme dhe për të ndërtuar një vend të fortë socialist modern." Thënë në vitin 2020, gjatë eventit, Sesiioni Plenar i Pestë i Komitetit Qendror të 19-të.

"Nëse dëshirojmë të krijojmë një vend të fortë socialist, është e domosdoshme të realizojmë rigjallërimin rural, të sigurojmë sigurinë ushqimore dhe të zhvillojmë bujqësinë e përparuar." Viti 2021, Konferenca Qendrore e Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësor.

"Bujqësia është themeli i vendit tonë, dhe fshatrat e pasura janë një garantes i fuqisë së qëndrueshme të vendit." Në vitin 2023, me rastin e Konferencës Qendrore të Punëve Rurale.

"Është e domosdoshme të përmirësohen sistemet mbështetëse për të forcuar bujqësinë, për të përfutur fermerët dhe për të pasuruar zonat rurale." Dhjetor 2024.

Shihet qartë se deklaratat e Xi Jinping theksojnë angazhimin e tij të fortë për zhvillimin e zonave rurale si një përparësi strategjike për ndërtimin e një shteti socialist modern dhe të fuqishëm. Përprjekjet e tij për rigjallërimin rural synojnë të ndërtojnë një bazë të fortë për fuqizimin e shtetit, duke bërë që fshatrat të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, si dhe në arritjen e qëllimeve të politikës kombëtare të Kinës.

Së fundmi, "Dokumentin Qendror Nr. 1" është një tjetër dëshmi e aftësive dhe ambicieve të Kinës. Është një kujtesë që edhe përballë sfidave të mëdha, progresi është i mundur. Por është gjithashtu një thirrje për veprim—një thirrje për të rimënduar mënyrën se si aplikohet qasja ndaj zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe inovacionit.

Një shprehje kineze thotë "Bima e mirë mund të rritet ngadalë, por rrënjët e saj janë të forta." Kjo pasqyron më së miri qëndrueshmërinë dhe fuqinë e zhvillimit, ashtu si reformat dhe investimet e Kinës në zonat rurale.

Dr. Marsela Musabelliu
Drejtoresh Ekzekutive e Institutit të Studimeve të Globalizimit (AIGS)

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga numri i kaluar)

Bari Robert (Geranium robertianum)

Geranium robertianum, i njohur zakonisht si barbarozë-robert, ose (në Amerikën e Veriut) barbaroza e Robertit, është një specie barbarosa (sqepeljleku) që është e përhapur në



të gjithë hemisferën veriore dhe është futur në disa vende në jugë. Është e zakonshme në pyje, gardhe, kopshte dhe në tokë të mbeturinave, dhe gjithashtu mund të gjendet në plazhet me zall dhe trotualet gëlqerore. Nuk konsiderohet si i rrallë apo i kërcënuar, por në disa vende konsiderohet të jetë pushtues.

Përshkrimi. Lulja ka dhjetë stamena në dy unaza nga pesë, anërat e brendshme hapen së pari. Bari-robert është një barishte shumëvjeçare e vogël, zakonisht dyvjeçare, por ndonjëherë njëvjeçare ose edhe jetëshkurtër, e cila zakonisht rritet në rreth 30 cm e gjatë dhe e gjerë, ose ndonjëherë deri në rreth dyfishin e asaj madhësie. Bimët e reja kanë një kërcell vegetativ shumë të shkurtër me një rozetë bazale gjethesh në gjethe të gjata (2-5 cm), ndërsa bimët e vjetra nxjerrin kërcell lulëzues nga sqetullat e një ose më shumë prej këtyre gjetheve bazale. Këcejtë e lulëzuar mund të dalin vertikalisht ose të shtrihen përgjatë tokës, dhe disa prej tyre mund të kthehen në stolone duke lëshuar rrënjë në nyjet. E gjithë bima është me qime të ndryshme, me një përzierje qimesh të gjata të thjeshta dhe atyre më të shkurtra me majë të gjendrës. Materiali i freskët ka një erë të fortë të pakëndshme kur shtypet ose shkulët, por kjo veti zbehet me kalimin e kohës. Ngjyra e saj mund të ndryshojë nga krejtësisht e gjelbër, në të kuqërremtë në nyjet ose në kërcell ose gjethe, ose e gjithë bima (përveç petaleve) mund të jetë e kuqe e ndezur, veçanërisht kur rritet në diell të fortë.

Gjethet janë zakonisht ternate ose palmate. Gjethet vendosen në mënyrë alternative përgjatë kërcellit dhe zakonisht ndahen në tre lobe me kërcell, dy të poshtmet prej të cilave ndahen më tej për të krijuar një skicë me 5 lobe (pëllëmbë), deri në rreth 11 cm në diametër në gjethet më të mëdha dhe më të ulëta. Fletëzat janë me lobe të thella dhe të dhëmbëzuara, me një majë të shkurtër mucronate në secilin lob.

Lulëzimi ndodh nga fillimi i pranverës deri në fund të vjeshtës në Evropën veriore dhe bimët mbeten të gjelbra gjatë dimrit. Lulëzimi është në një pedinkule të gjatë, që del përballë një gjetheje në kërcellin

e lulëzuar dhe përbëhet nga një palë lule trëndafili biseksuale, me diametër 12-16 mm, në kërcell të shkurtër (1 cm). Shpesh një nga dy lulet në një palë do të dështojë. Pesë sepalet janë rreth 5 mm të gjata, heshtake dhe të veshura me qime të gjendrave dhe të gjendrave me majë rozë. Petalet janë të gjata nga 8 deri në 14 mm, ngjyrë vjollcë-rozë me vija të bardha dhe me kthetërren (pjesa bazale si kërcell) pak më e shkurtër se gjymtyra. Nuk ka asnjë pikë në majë të petaleve, ndryshe nga disa geraniume të tjera. Ka 10 stamena në dy unaza me nga 5 që dalin pak përtej lules, me anëra të purpura dhe polen të verdhë; unaza e brendshme e anterave hapet së pari. Pjesa femërore e lules përbëhet nga 5 karpele me një stil, e cila ndahet në 5 stigma rozë në pjesën e sipërme. Këto janë përhapur tashmë kur lulja hapet, gjë që lehtëson vetëpollenim, megjithëse ndodh edhe pjalmimi i kryqëzuar. Forma me lule të bardha, e quajtur ndonjëherë variteti alba, është mjaft e zakonshme.

Fruti është një skizokarp, i cili në maturim ndahet në 5 merikarpë cilindrikë me gjatësi 2,5 mm. Këto janë të vendosura në bazën e stilit, baza e të cilit (kolona) zgjatet në rreth 1,5 cm me zhvillimin e frutave. Kur fruti është i pjekur, tenda përkulet lart në mënyrë shpërthyes nga baza, duke i nxjerrë frutat në një distancë prej një metri nga bima mëmë.

Identifikimi. Barbarosa të tjera që duken mjaft të ngjashme përfshijnë Barbarosa e shndritshme, e cila ka gjethe të rrahura, por të pandarë dhe krahun me kërcell të gjatë, i cili ka pika të gjata në sepalë. Në pamje është shumë i ngjashëm me robinin e vogël, por kjo specie ka lule më të vogla (5-9 mm), anëra të verdha dhe pa erë.

Një barbarosa e zakonshme me gjethe me kërcell të kuq me erë të fortë dhe lule rozë, vendos në rajonet e buta veriore. Kjo bimë ka kërcell të kuq të dukshëm dhelule të vogla rozë me pesë petale. Ajo ka fruta me sqep me sepale leshore. Lulet janë të ngjashme me shiritin e barbarosës së ndritshme. Bari-Robert ka gjethe pak me qime të cilat janë shumë më të ndara se gjethet me shkëlqim dhe pa qime të barbarosës së zakonshme. Bar-Robert ka fruta me qime. Në Barbarosa frutat janë më shumë ose më pak pa flokë. Familja:Familja e geraniumit – Geraniaceae. Bimë Vjetore / dyvjeçare me lartësi40 cm. Bima lulëzon në muajt Maj-Shtator.

Valeriana e kuqe (Sanza) (Centranthus ruber)

